



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar”.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Arben Pëllumbi, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë

Illir Bejko - Drejtor i Oponencës Ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit

Ketrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore në Ministrinë e Drejtësisë

Agnes Bernhard - shefe e misionit të EURALIUS-it

Darian Pavli - ekspert i lartë vendas i EURALIUS-it

Tedi Dobi - ekspert vendas i EURALIUS-it

Mimoza Sadushaj - presidente e Dhomës Kombëtare të Noterëve
Fatmir Lacej - zëvendës-president i Dhomës Kombëtare të Noterisë
Elona Saliq - notere në Tiranë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme, meqenëse plotësohet kuorumi. Sot në rendin e ditës kemi vetëm 1 çështje;

shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë, i ndryshuar”. Komisioni ynë është komision përgjegjës dhe relatore është kolegia Vasilika Hysi. Ky është një nga projektligjet e depozituar në kuadër të reformës në drejtësi, si projektligj është votuar në parim dhe sot jemi në fazën e shqyrtimit nen për nen.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zonja Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë, dhe stafi që e shoqëron, ndërsa nga misioni ndërkombëtar i EURALIUS-it, zonja Agnes Bernhard, shefe e misionit, zoti Darian Pavli, ekspert i lartë vendas, dhe zoti Tedi Dobi, ekspert vendas.

Nga Dhoma Kombëtare e Noterisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zonja Mimoza Sadushaj, presidente e Dhomës Kombëtare të Noterisë, zoti Fatmir Lacey, zëvendës-president i Dhomës Kombëtare, dhe zonja Elona Salia, notere në Tiranë.

Përpara se të fillojmë mbledhjen dhe t’ia jap fjalën ministres së Drejtësisë, zonjës Gjonaj, për të bërë një prezantim të gjetjeve dhe opinioneve që ka Ministria e Drejtësisë lidhur me projektligjin “Për noterinë”, më lejoni, në emër të Komisionit të Ligjeve të uroj zotin Darian Pavli për zgjedhjen e tij si gjyqtar në Gjykatën e Strasburgut dhe t’i urojmë suksese!

Zoti Pavli, urime dhe suksese!

Zonja Ministre, mirë se keni ardhur në komision!

Ashtu siç e bëra prezent pak më parë, sot kemi projektligjin “Për noterinë”. Ky është një ligj shumë i rëndësishëm, me impakt të gjerë për publikun, pasi kemi të bëjmë me një shërbim të drejtpërdrejtë për qytetarët. Është një projektligj që, në fazën e depozitimit nga kolegu Shameti, ka qenë në variantin siç është i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, pra një projektligj me rreth 36 nene, në mos gaboj, por, pas diskutimeve dhe tryezave të organizuara, pas sugjerimeve dhe komenteve pafund që kanë ardhur në lidhje me këtë projektligj, relatorja, nismëtari dhe grupi i punës kanë arritur në një variant të projektligjit që shkon diku te rreth 169 nene. Sidoqoftë, jemi në një fazë të shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji dhe unë shpresoj që edhe me diskutimet ndërmjet kolegëve, të kemi një variant përfundimtar të këtij projektligji.

Fjala është për ju, zonja Ministre!

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, në momentin që ky projektligj ka ardhur për të dhënë mendimet e tij, ne e kemi shqyrtuar me seriozitet dhe është një punë disamujore e stafit të ministrisë. Njëkohësisht, është punuar dhe janë marrë në konsideratë edhe modelet e vendeve të tjera evropiane, me të cilat kryesisht, kemi ngjashmëri të sistemit të shërbimeve të profesioneve të lira. Duke marrë në konsideratë të gjithë reformën që qeveria ka shpallur për të gjitha profesionet e lira, pikërisht të katërt projektligjet, ku dy prej tyre tashmë kanë kaluar dhe dy projektligje të tjera, që sot janë në diskutim në Komisionin e Ligjeve, e bëjnë atë një kuadër të plotë në zbatim të reformave, qëllimit dhe objektivave që qeveria ka vënë për sa i përket përmirësimit të profesioneve të lira.

Projektligji “Për noterinë” i është nënshtruar procesit të shqyrtimit nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Drejtësisë, po ashtu kemi bërë edhe disa diskutime me kryetaren e Dhomës Kombëtare të Noterisë, me misionin EURALIUS, por, njëkohësisht, edhe me ekspertë të tjerë gjermanë.

Në këtë prezantim që do të bëj për sa u përket mendimeve dhe komenteve që ka Ministria e Drejtësisë lidhur me projektligjin, këtë e kemi parë në këndvështrimin e problematikave që janë ndeshur gjatë këtyre viteve, gjatë monitorimit të licencimit të noterëve, si dhe kualifikimit të tyre të ndeshura gjatë ushtrimit të funksioneve rregullatore nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Për sa i përket hyrjes në profesion, projektligji parashikon ndryshime thelbësore, duke parashikuar, nga një anë, zgjatjen e periudhës së praktikës në 3 vjet, nga një vit që është aktualisht, si një periudhë e detyrueshme pranë Qendrës Shqiptare të Trajnimit të Noterëve, si një institucion i ri, që parashikohet të ngrihet dhe të administrohet nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, e cila do të sigurojë programin e detyrueshëm të trajnimit fillestar të kandidatëve për noterë, por, njëkohësisht, do të jetë kusht për marrjen e licencës së noterit, si dhe detyrimin e tyre për t’ju nënshtruar më pas trajnimit vazhdues, i cili përgatitet nga Dhoma Kombëtare e Noterëve.

Duhet mbrojtur në konsideratë se për të gjitha profesionet e lira ne po tentojmë të përfshijmë një mënyrë të re të mënyrës se si këta kandidatë, përpara se t’i nënshtrohen testimit, të ndjekin një trajnim fillestar, i cili është shumë i ngjashëm në kohëzgjatje, por, njëkohësisht, për qëllimin që ka me të gjitha profesionet e lira, gjithashtu duke pasur një ngjashmëri me trajnimin vazhdues dhe fillestar, që ndjekin magjistratët në Shkollën e Magjistraturës. Në vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë profesionalizmi i lartë i kategorisë së noterëve garantohet

përmes një përzgjedhje të kujdesshme gjatë provimit të noterisë, programimit të qartë të hyrjeve në profesion, sipas një numri të përcaktuar, si dhe përmes ushtrimit profesional të mbikëqyrjes së veprimtarive të noterëve nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Noterisë. Duke e parë gjithmonë si një partner shumë të mirë Dhomën Kombëtare të Noterisë.

Gjithashtu, duhen trajtuar me kujdes të veçantë dispozitat që rregullojnë procedurat dhe testimet që një kandidat duhet të kalojë në kuptim të garancive, për rritjen e profesionalizmit dhe cilësisë së noterëve. Ky fakt, bashkërisht me propozimin e projektligjit për përgjysmimin e numrit aktual të noterëve, mund të na krijojë një pasiguri dhe të dekurajojë të gjithë ata që duan të ushtrojnë këtë profesion.

Për garantimin e kriterëve dhe standardeve të sipërcituara është e rëndësishme që projektligji të përcaktojë se programet e trajnimit të miratohen paraprakisht nga Ministria e Drejtësisë, për të garantuar kështu cilësinë e kandidatëve që kualifikohen për t'u licencuar. Kjo jo për të kufizuar kompetencat e Dhomës, por me qëllim kalimin e një filtri më shumë të një prej hapave mjaft të rëndësishëm deri në licencimin, pasi pasohet me ushtrimin efektiv të profesionit.

Në këtë projektligj problematikë shfaqet raporti i numrit të noterëve me numrin e popullsisë, ku thuhet 1 me 15 mijë nga e cila deri vonë edhe numri i zëvendësnoterëve. Duke marrë në konsideratë numrin e noterëve që janë aktualisht, rreth 470, me një përlllogaritje të thjeshtë aritmetike, rezulton që, të arrihet raporti që propozon projektligji, duhet që të mos organizohen më konkurse, testime të provimit të noterisë, për t'u certifikuar më pas noterë dhe të mos lëshohen më licenca të reja për një periudhë prej 15 vjetëve, derisa numri i noterëve të shkojë në raportin e kërkuar të popullsisë.

Nga një studim që u është bërë vendeve të këshillit të noterëve të Bashkimit Europian, kriteret kryesore të miratuara për përcaktimin e numrit të noterëve bazohen në kriterin e raportit, numri i banorëve për noter dhe numri i akteve noteriale të prodhuara. Megjithatë, asnjë shtet nuk ka vendosur në të gjithë studimin krahasimor që ne kemi bërë pothuajse me 4 vendet e Bashkimit Europian në mënyrë të detajuar, formulat të paracaktuara, por miraton kriteret udhëzuese për vlerësimin rast pas rasti të situatave social ekonomike të momentit. Në këtë kontekst, edhe Dhoma e Gjermane e Noterisë, ku ky projektligj me ndryshimet që sjell, kryesisht i referohet këtij sistemi dhe është asistuar ngushtësisht në hartimin e këtij projektligji, ka pranuar që një ulje drastike dhe e menjëhershme mund të mbyll profesionin për aplikantët e rinj për vite me radhë, e cila do të ishte në kundërshtim me interesat e profesionit dhe të drejtën për të hyrë në profesion, duke marrë në konsideratë se si vitet e fundit është bërë testimi për

licencimin e noterëve dhe duke marrë në konsideratë se licencimi i viteve të fundit lë shumë për të dëshiruar, qoftë edhe për sa i përket rregullshmërisë së veprimeve ligjore.

Në projektligj është parashikuar si koncept roli i zëvendësnoterit. Ky pozicion nuk është i mirërregulluar në lidhje me mënyrën se si do të funksionojë në praktikë, kompetencat, detyrat që do të ushtrojë, si dhe raste e delegimit të kompetencave nga noteri ku ushtron veprimtarinë, për shkak se zëvendësnoteri nuk është një person i kualifikuar si noter, është i paçertifikuar dhe nuk mund të kryejë veprime noteriale. Kjo formë, në konsideratat e Ministrisë së Drejtësisë, rrezikon të cenojë sigurinë juridike, që duhet të ofrojë ky shërbim për palët. Një arsyetim i tillë rezulton edhe nga rregulli i mirëpranuar i të drejtës ndërkombëtare, se në procesin e hartimit të dokumentit publik noteri duhet të jetë i pranishëm personalisht dhe nuk mund t'ia delegojë kryerjen e funksioneve të tij personave të tjerë. Duke e marrë në konsideratë që ky është një institut i ri, i cili prezantohet në projektligj, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në detyrat, funksionin dhe përgjegjshmërinë që do të ketë zëvendësnoteri në lidhje me veprimet që kryhen apo aktet noteriale.

Ministria e Drejtësisë ka qenë, është gjithmonë e gatshme dhe ka pasur një bashkëpunim të mirë me Dhomën Kombëtare të Noterisë, njëkohësisht është e gatshme të japë kontributin dhe mbështetjen për forcimin e rolit të noterit, që, siç e thashë edhe më parë, është një ndër prioritetet e qeverisë.

Cilësia e noterëve lidhet drejtpërdrejt me forcimin e besimit të publikut në ofrimin e këtij shërbimi, duke ndikuar në ofrimin e shërbimit në mënyrë cilësore dhe profesionale.

Nisur nga problematikat e hasura në praktikë dhe nga zbatimi i saj deri tani, duke e harmonizuar edhe me kuadrin ligjor në fuqi, sugjerojmë që projektligji të ketë parashikime specifike për të rregulluar pozicionin e noterit.

Lidhur me parashikimin e raportit të ri të numrit të noterëve me numrin e popullsisë; për caktimin e kriterëve të qarta për rregullimin e pozicionit të zëvendësnoterit, si dhe kompetencat e tij; përrregullat më të detajuara për procedimin disiplinor, ku sot është një ndër problematikat që paraqitet më shumë në Ministrinë Drejtësisë për procedimet disiplinore të noterëve; për caktimin e kriterëve dhe procedurave të qarta dhe të plota për të rregulluar masat disiplinore dhe kushtet për dhënin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit; për rregullimin që ushtron ministri i Drejtësisë si organi kompetent për licencimin e noterëve, si dhe ndryshimin e parashikimit ligjor në lidhje me tarifën e inspektimit në kushtet që ky funksion ushtrohet nga strukturat e ngritura dhe funksionale të Ministrisë së Drejtësisë, vlerësoj se projektligji duhet të reflektojë idenë e një profesioni që vjen me një rregullim të veçantë

arsimor ose status profesional, me qëllim që të garantohet edhe monitorimi efektiv i këtij profesioni nga Ministria e Drejtësisë.

Sot ne jemi në gjendje të kontrollojmë noterët, por disa mungesa të parashikimeve ligjore na e bëjnë atë proces shumë të zgjatur, shpeshherë edhe pengues, ndoshta nga disa dhoma të noterëve, që na bën të mos ndëshkojmë në kohën e duhur noterët, të cilët kryejnë shkelje abuzive. Prandaj, mendoj se është thelbësor saktësimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë, si organi që ka detyrimin të sigurojë profesionalizmin e këtij shërbimi.

Pavarësisht se ne e marrim Ministrinë e Drejtësisë pas 12 vjetësh, dua t'ju them se unë si ministre Drejtësie, por edhe si qeveri kemi menduar për mënyrën sesi të rregullojmë profesionet e lira. Unë kam pezulluar çdo lloj procedure, që ka të bëjë me licencimin e ri, pavarësisht se sot ligji ma mundëson të drejtën të bëj teste të noterëve, por për të rregulluar një herë e mirë profesionin e noterit dhe për të mos pasur abuzime në mënyrën e testimin dhe për të pasur disa rregulla të detajuara, gjatë gjithë kësaj periudhe, për 1 vit e pak muaj nuk është kryer asnjë testim dhe asnjë licencim i noterëve, me qëllim që ligji të miratohet dhe më pas, në bazë të rregullave të reja procedurale, të mund të bëhet testimi ose licencimi.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka kolegja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e mendimeve apo qëndrimeve që ka Ministria e Drejtësisë!

Kam lexuar me vëmendje opinionin që ju keni përcjellë për projektligjin për noterinë. Krahas çështjeve që ju trajtuat, ka edhe elemente të tjera.

Projektligji është voluminoz, rregullon për herë të parë aspekte të rëndësishme të mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të Dhomës Kombëtare të Noterisë, por edhe vetë mënyrën e shërbimit të noterisë. Duke qenë se marrëdhëniet midis Ministrisë së Drejtësisë, institucioneve ose trupave të rinj, që krijohen dhe Dhomës kanë nevojë të qartësohen, meqë nuk kemi një pozicion të unifikuar, unë kërkoj që para se të kalojmë në diskutimin nen për nen të këtij projektligji, grupi i punës, ku të përfshihen propozuesi, Ministria e Drejtësisë, misioni EURALIUS, Dhoma dhe ekspertët që kanë punuar, bashkë me mua, ftoj të gjithë kolegët, që kanë dëshirë të jenë pjesë e këtij grupi, të ulemi dhe të analizojmë gjithçka që ka përcjellë Ministria e Drejtësisë.

Dje ka ardhur materiali dhe koha nuk na mundëson për të pasur një analizë të qartë dhe të saktë, por edhe një reflektim në formën e amendamenteve të qëndrimeve që do të

mbahen pasi të bëhet ky proces diskutimi në grup. Prandaj propozoj të ndërpresim diskutimin e mëtejshëm nën për nën të këtij projektligji dhe të vazhdojmë menjëherë me punën në grup.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka propozuesi i projektligjit, zoti Shameti.

Adnor Shameti - Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë se e tha edhe relatorja e projektligjit, varianti origjinal i depozituar në Kuvend është dukshëm i ndryshëm nga ai i përpunuar nga grupi i ekspertëve dhe, duke qenë se në analizën e fundit nuk kemi rakorduar 100% në të gjitha detajet dhe elementet e ligjit, për të qenë më operative dhe në analizën përfundimtare që do t'i bëjmë nën për nën këtij projektligji, të kemi një gjuhë dhe gjetjet të jenë të rakorduara, i rekomandoj komisionit që ta shtyjmë shqyrtimin dhe analizën nën për nën të këtij projektligji për në një seancë të dytë dhe bashkë me grupin e ekspertëve të nivelit të lartë të rakordojmë të gjitha qëndrimet.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit!

Etilda Gjonaj - I vetmi koment që kam është se, meqenëse prezantohen një sërë parashikimesh të reja ligjore dhe drafti ka qenë në diskutim të vazhdueshëm me ekspertët e EURALIUS-it, me Dhomën apo me ekspertët e tjerë të Dhomës Gjermane të Noterisë, do të ishte mirë të pranojmë sugjerimin e zonjës Hysi, me qëllim që të diskutojmë të gjitha këto institute të reja, të cilat prezantohen në projektligji.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Mimoza Sadushaj – Edhe unë ju falënderoj!

Kuptohet që edhe ne jemi dakord që të shtyhet ky diskutim, sepse duhet të njihemi me opsionet e Ministrisë së Drejtësisë, por mendoj se, duke qenë se kemi një shërbim noterial vërtet problematik në Shqipëri, ndoshta duhet të përshpejtojmë pak me amendimet, sepse u bënë pothuajse dy vjet që ne rikthehemi në të njëjtën pikë. Kështu që mendoj se është mirë të njihemi dhe të diskutojmë me përfaqësuesit e ministrisë, me ekspertët, me Dhomën dhe me EURALIUS-in të biem dakord dhe pastaj të vijmë në komision.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Bernard, nga misioni EURALIUS.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesi)* EURALIUS-i ka asistuar dhe ka ofruar ndihmën e tij gjatë gjithë punës së bërë në këtë periudhë 2-vjeçare dhe do të vazhdojë të ofrojë ndihmën e tij, në mënyrë që të kemi variantin më të mirë të ligjit për qytetarët shqiptarë.

Ulsi Manja- Edhe unë bashkohem me propozimin e koleges Hysi, që mbledhja të shtyhet në një seancë tjetër, por dua të sjell në vëmendjen e të gjithë kolegëve, opinionit publik, relatorit, nismëtarit, ministrit të Drejtësisë, misionit EURALIUS-it dhe Dhomës se puna për adresimin e këtyre gjetjeve që u prezantuan sot në komision nga Ministria e Drejtësisë dhe nga relatorja duhet të fillojnë që tani.

Ky ligj, i cili ka dy vjet që është në tryezën e Komisionit të Ligjeve për t'u diskutuar, të jeni të sigurt se javën tjetër do të mbarojë miratimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit dhe do t'i drejtohet seancës plenare.

Është shumë e rëndësishme që të ndahen ato gjëra, të cilat janë parimore dhe për t'u diskutuar nen për nen, të cilat janë çështje të diskutimeve dhe debatit teknik.

Mos harroni se ky projektligj është miratuar në parim nga Komisioni i Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, që do të thotë se kjo maxhorancë, ky komision dhe ky Kuvend kanë rënë dakord që do të kemi një ligj të ri për noterinë. Diskutimet e tjera janë të karakterit teknik. Çështja nëse do të kemi në ligj një përcaktim të numrit të noterëve sipas numrit të popullsisë apo jo, është parimore. Nëse do ta kemi 1 për 15 mijë, 1 për 10 mijë apo 1 për 7 mijë, kjo është çështje e studimeve të hollësishme që janë bërë për këtë projektligj. Këto gjëra nuk mund t'i diskutojmë pafundësisht. Janë organizuar dhjetëra tryeza për këtë projektligj, si për të gjitha projektligjet e tjera. Ndaj, do t'ju lutem, sapo të përfundojmë mbledhjen e komisionit, ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë, të Dhomës Kombëtare të Noterisë, ekspertët e EURALIUS-it, relatorja, nismëtari dhe kushdo nga kolegët e Komisionit të Ligjeve që dëshiron të japë kontribut për përmbyllje sa më shpejt të këtij projektligji, të fillojnë punën. Javën tjetër ky projektligj do të miratohet në Komisionin e Ligjeve. Nuk ka diskutim tjetër. Nuk mund ta shtyjmë. Dy vjet janë shume. Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Shumë faleminderit, zonja Ministre, për prezencën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtyhet, zoti Braho, sepse Ministria e Drejtësisë dje ka sjellë disa komente që, në vlerësimin e relatores, kanë të bëjnë me thelbin e projektligjit. Pra, nga varianti i depozituar në për diskutim në Komisionin e Ligjeve me propozimet që ka sjellë dje Ministria e Drejtësisë, vlerëson se këto propozime prekin thelbin e projektligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“T'i kishin mbyllur”, është koha e shkuar, zoti Braho, fakt është që nuk i kanë mbyllur. Kështu që e hedhim në votë, në qoftë se duhet.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nuk ka nevojë për votim, se ne e kemi kaluar në parim projektligjin dhe jemi në një proces tjetër. Ajo për të cilën unë dhe zoti Braho kemi vërejtje është se projektligji i propozuar nga kolegu ynë ka ardhur me 76 nene, një projektligj për të cilin relatorja ka bërë një punë shumë të mirë me grupet e interesit gjatë gjithë kësaj kohë, ka shkuar në 164 nene. Kjo do të thotë se edhe materialin e ri që ka sjellë Ministria e Drejtësisë, të cilin, për hir të së vërtetës duhej ta kishte sjellë edhe më parë, shumë mirë që po e vonojnë pak për të nxjerrë një ligj sa më të mirë. Nuk ka asnjë problem që të nxitohemi dhe të themi pastaj: pse nuk kaluam edhe këtë apo atë? E rëndësishme është që Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma e Noterisë të jenë unison dhe të kenë një draft ku edhe ne të jemi të saktë. Vërejtja që kam unë personalisht është se relatorja duhet të na e vërë në dispozicion pak më shpejt, meqenëse është një ligj voluminoz dhe, meqenëse ju këmbëngulni me të drejtë që javën tjetër duhet ta kalojmë nen për nen, materialin integral, edhe me bold, për sa u përket mendimeve që kanë Ministria e Drejtësisë, Dhoma e Noterisë dhe EURALIUS-i që ne ta lexojmë paraprakisht dhe të dimë ndryshimet, sepse ka një ndryshim shumë të madh nga propozimi që ka bërë Adnori me këtë. Është një ndryshim i jashtëzakonshëm. Ju duhet t’u jepni urdhër stafeve tuaj që në fund të kësaj jave ose në fillim të javës tjetër (nuk e di kur do të jetë gati relatorja pas kësaj letre që ka sjellë ministrja e Drejtësisë) të jetë gati, që ne të kemi kohën e nevojshme që ta lexojmë që të vijmë këtu dhe ta kalojmë sa më shpejt, sepse janë 164 nene. Të mos vonohemi kot gjithmonë: shty, e shty. Për shembull, çfarë do të bëjmë sot me këtë material që na ka sjellë Vasilika? Besoj se ky material duhet të parë në thelb me këto ndryshime. Do të bëhet një material tjetër integral, por duhet marrë edhe mendimi i Dhomës së Noterisë për ta bërë tamam.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Hysi një koment të shkurtër.

Vasilika Hysi – Unë jam plotësisht dakord me sugjerimin që bëri kolegu Fino dhe ky është edhe sugjerimi im. Dëshiroj të ritheksoj edhe një herë se jam njohur me opinionin e Ministrisë së Drejtësisë dje pasdite vonë. Kjo do të thotë se takimin e grupit të punës e bëmë sot në mëngjes. Unë konstatova, dhe këtë shqetësim e ndava që dje në mbrëmje me kryetarin e Komisionit, se drafti që ju keni përpara, të nderuar kolegë dhe sugjerimet dhe rekomandimet që ka bërë Ministria e Drejtësisë nen për nen janë thelbësore në ligj dhe është e drejtë që, pasi të ulemi në grupin e punës, t’i shohim një për një dhe të themi cili pranohet dhe cili nuk pranohet. Nëse nuk pranohet, si të do të riformulohet? Pa dyshim që ky komision do të ketë një variant ku do të thuhet se për këtë nen ka dakordësi dhe për këtë nuk ka dakordësi.

Gjithashtu, ju ngritët një problem të dytë të variantit të depozituar dhe variantit që keni tashmë. Ka ndryshime të mëdha, sepse ka qenë një proces konsultimi dhe ju e dini se ky ligj nuk mund të kalojë pa certifikimin e misionit EURALIUS. Shumë nga sugjerimet dhe mendimet kanë ardhur nga misioni EURALIUS dhe Dhoma Gjermane e Noterisë, me të cilat jam njohur vonë. Prandaj kërkoj kohën e duhur.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zonja Hysi!

Më këtë koment të zonjës Hysi e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Mbledhja e radhës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Ftoj ekspertët që të fillojnë pa vonesë punën për këtë projektligj.

MBYLLET MBLEDHJA